



## *“Niveli i edukimit finanziar të studentëve”.*

Fletëpalosje në kuadër të projektit të Universitetit të Tiranës:

Ky projekt konsistoi në një studim kërkimor për të përcaktuar nevojat për edukim finanziar tek të rinjtë, me fokus specifik studentë të UT, të fakulteteve joekonomike, si dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi mangësitë dhe problematikat që shfaqin lidhur me çështjet financiare.

Në kushtet e zhvillimit të shpejtë të tregjeve financiare dhe teknologjisë pritet që individët të përballen gjithnjë e më tepër me produkte të reja dhe të shumëlojshme financiare, duke bërë më komplekse vendimarrjen e tyre financiare. Të pasurit e koncepteve bazë financiare, si dhe njohja e karakteristikave të produkteve aktuale financiare, rrit mundësitë që individët të kuptojnë, njohin dhe përshtaten shumë më shpejt produktet e reja financiare ndër vite,

duke marrë edhe vendime të drejta financiare, për të ndikuar në nivelin e tyre të jetesës.

Rëndësi të veçantë ky edukim merr për të gjithë qytetarët shqiptarë, por në veçanti për të rinjtë e studentët të cilët do të përballen dhe do të kenë ndikim në to për një periudhë më të gjatë kohe.

Grupi i punës, i përbërë nga pedagogë të Departamentit të Financës, Fakulteti Ekonomik, të Universitetit të Tiranës, mbas studimit të kryer evidentoi çështjet ku u hasën më tepër vështirësi nga studentët dhe ka përgatitur këtë fletëpalosje si dhe webinarë, të cilët mund të aksesohen lirisht nga të gjithë të interesuarit në faqen:  
<https://sustainablefinance.feut.edu.al/>

*Ju mirëpresim*

## *“Planifikimi Financiar”*



Familja financiare përkufizohet si një grup personash (duke marrë parasysh edhe një person të vetëm) të cilët ndajnë në mënyrë të përbashkët mirëqëni, pasurinë, të ardhurat dhe shpenzimet. Financa personale konsistojnë në studimin e burimeve të familjes, të rëndësishme në përbushjen e suksesit financiar, pra ka të bëjë me mënyrën se si njerëzit shpenzojnë, kursejnë, mbrojnë dhe investojnë paratë e tyre. Ajo ndihmon në shmangien e vështirësive financiare dhe në shfrytëzimin e mundësive që të ofrohen.

Planifikimi financiar është procesi i hartimit dhe zbatimit të një serie planesh dhe strategjish, i cili mbulon aspekte të ndryshme të financave të familjes, me qëllim që të arrihet përbushja e objektivave financiare. Buxhetimi është element thelbësor i tij.



## *“Normat e interesit”*

Vlera në kohë e parashë është një koncept i cili tregon se një shumë parash sot ka më tepër vlerë se e njëjta shumë në të ardhmen, për shkak se paratë që marrim sot mund të investohen kundrejt një norme interesit dhe në të ardhmen të kemi një sasi më të madhe parash.

Interesi është pagesa që bëhet për përdorimin e parave për një periudhë të caktuar kohe. Interesi mund të jetë i thjeshtë, kur llogaritet vetëm mbi shumë fillestare të parave, ose i përbërë kur llogaritet edhe mbi interesat e fituar në periudhat e mëparshme.

Për shembull, nëse vendosim paratë në një depozitë në bankë, pas disa vitesh do të fitonim më shumë nëse interesit i llogaritur do të ishte interes i përbërë, sesa interes i thjeshtë.

## *“Tatimet dhe taksat”*



Tatimet janë pagesa të detyrueshme, që shteti vendos për personat fizik dhe juridik në bazë të sovranitetit të tij, në mënyrë që të sigurojë të hyra për të mbuluar shpenzimet publike, pra për të realizuar funksionet e tij.

Këto pagesa të detyrueshme, kanë si karakteristikë që janë pa kundërshpërbirim të drejtpërdrejtë, pra shteti nuk u ofron një shërbim publik të drejtpërdrejtë në këmbim të pagesës.

Taksa është një kontribut i kërkuar për t'u paguar nga çdo person i cili drejtpërdrejt përfiton një shërbim publik.

Pavarësisht, se thuhet kontribut i kërkuar për t'u paguar, në të vërtetë është një pagesë e detyrueshme për tu paguar, nëse institucioni ofron një shërbim publik të caktuar. Në dallim nga tatimi, taksa është me kundërshpërbirim të drejtpërdrejtë.

## *“Investimet në Familje”*



Investimet përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të menaxhimit financiar personal, duke ofruar mundësi për rritjen e pasurisë dhe stabilitetin ekonomik. Njohja e alternativave investuese është thelbësore që individi të diversifikojë portofolian e tyre. Investimet karakterizohen nga rreziqe të ndryshme, duke u kategorizuar në investime me risk të ulët: bono thesari, depozita kursimi, fonde të përbashkëta (fonde investimesh), që janë shumë më të përshtatshme dhe karakteristike për familjet, si dhe investime me risk më të lartë, si aksione, pasuri të paluajtshme, obligacione, të cilat kërkojnë një vlerësim të kujdeshëm për të minimizuar humbjet potenciale.

Investimi në Fondet Private të Pensionit nuk duhet neglizhuar për të pasur një jetesë cilësore në të ardhmen.